

MANUAL LIDHUR ME APLIKIMIN E URDHËRIT PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME



**MANUAL LIDHUR ME APLIKIMIN E URDHËRIT
PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME**

Autor i raportit:

Gzim Shala

Botues:

OJQ AKTIV

Redaktor:

Miodrag Milićević

March 2024

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare nga UNMIK-u në kuadër të projektit “Mbështetje e mëtutjeshme për qasje në drejtësi dhe të drejtat e njeriut në rajonin e Mitrovicës”.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e OJQ Aktiv dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNMIK-ut.

Përmbajtja

Hyrje	7
Kuptimi dhe qëllimi i urdhërit për punë në dobi të përgjithshme	9
Urdhri për punë në dobi të përgjithshme si zëvendësim i dënimit kryesor dhe si dënim alternativ	13
Urdhri për punë në dobi të përgjithshme tek të rriturit si zëvendësim i dënimit kryesor	17
Rastet kur lejohet shqiptimi i urdhrit për punë në dobi të përgjithshme	17
Si zëvendësim i dënimit kryesor	17
Si dënim alternativ	17
Marrja e pëlqimit	17
Kohëzgjatja e urdhrit	17
Revokimi i urdhrit	19
Urdhri për punë në dobi të përgjithshme tek të miturit	21
Puna në dobi të përgjithshme si masë e diversitetit	21
Kushtet për shqiptimin e urdhrit për punë në dobi	22
Kohëzgjatja e masës	22
Revokimi i masës	23
Urdhri për punë në dobi të përgjithshme si dënim	23
Kushtet për shqiptimin e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme	23
Kohëzgjatja e urdhrit	25
Revokimi i urdhrit	25
Ekzekutimi i urdhrit	25
Zbatimi dhe mbikëqyrja e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme	27
Ekzekutimi i urdhrit për punë në dobi të përgjithshme	27
Programi i punës në dobi të përgjithshme	27
Procedura për revokimin e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme	29
Fillimi i procedurës dhe juridiksioni	29
Zhvillimi i procedurës dhe vendimi	30

1 HYRJE

Puna në dobi të përgjithshme synon risocializimin dhe riintegrimin e të kryersit të veprës penale, pa i shqiptuar dënim me burgim. Dënimi me burgim, si dënimi më tradicional penal, i është nënshtruar kritikave të shumta, me ç'rast janë shqyrtuar alternativat e tij. Puna në dobi të përgjithshme është njëra prej këtyre alternativave.

Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës e ka paraparë urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. Ky Kod na e paraqet këtë urdhër në dy forma: Si zëvendësim i dënimit kryesor, qoftë atij me burgim apo atij alternativ, si dhe si dënim alternativ. Kriteret për aplikimin e këtij urdhri dallojnë nga njëra formë prej tjetrës.

Në anën tjetër, pos tek të rriturit, urdhri për punë në dobi të përgjithshme aplikohet edhe tek të miturit. Kjo rregullohet me Kodin Nr.06/L-006 e Drejtësisë për të Mitur. Edhe në këtë fushë, urdhri për punë në dobi të përgjithshme paraqitet në dy forma: Si masë e diversitetit dhe si dënim për të miturit.

NGO ~~Activ~~ në qershor 2023 publikoj raportin “Dënimi alternativ për punë në dobi të përgjithshme”. Njëra prej rekomandimeve të dala nga ky raport është ishte që me qëllim të trajnimit adekuat të gjyqtarëve, përfshirë prokurorët e shtetit, si dhe përvetësimin e njohurive të veçanta në fushën e zbatimit dhe ekzekutimit të dënimeve alternative, duhet të hartohet një doracak i veçantë që do t'i ndihmonte gjyqtarët në punën e tyre të përditshme.

Ky Manual paraqet sqarime të detajuara lidhur me aplikimin e urdhrin për punë të përgjithshme. Në këtë Manual, urdhri për punë në dobi të përgjithshme trajtohet në të gjitha situatat dhe stadet procedurale, brenda secilit kontekst. Kështu, ky Manual, pas sqarimit të kuptimit dhe qëllimit të këtij urdhri, sqaron aplikimin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme si mënyrë e zëvendësimit të dënimit kryesor dhe aplikimin këtij urdhri si dënim alternativ. Po ashtu, sqarimet ipen si për aplikimin e këtij urdhri tek të rriturit ashtu edhe tek të miturit.

Tutje, ky Manual jep sqarime edhe në lidhje me mënyrën e ndërveprimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë me Shërbimin Sprovues, zbatimin dhe mbikëqyrjen e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme dhe deri tek revokimi i këtij urdhri.

Dilemat ligjore në lidhje me situata të ndryshme, është synuar që të qartësohen në këtë Manual. Kjo me qëllim të lehtësimit të aplikimit të këtij urdhri në praktikë, duke sqaruar mënyrën e veprimit në secilën situatë specifike.

2 KUPTIMI DHE QËLLIMI I URDHËRIT PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

Urdhëri për punë në dobi të përgjithshme bënë pjesë në kuadër të dënimeve alternative. Këto dënime, thënë shkurtë, lindën si nevojë për të lëvizur nga dënimi me burgim në dënime të tjera. Kështu, dënimet alternative janë vetëm alternativë e dënimeve kryesore. Dënimi me burgim, si dënimi më tradicional penal, i është nënshtruar kritikave të shumta. Fillimisht, dënimi me burgim është treguar si kundërproduktiv në rehabilitimin dhe riintegrimin e të kryerësve të vepra të lehta penale. Ky kundërproduktivitet ka qenë i shprehur edhe në rastet e dënimit të disa grupeve të cenushme. Përballë rritjes së aplikimit të dënimit me burgim, ka pak prova që rritja e aplikimit të këtij dënimi ka ngritur sigurinë publike¹.

Në anën tjetër, aplikimi i madh i dënimit me burgim mbipopullon edhe burxhet. Në këtë situatë, krijohet potencial i lartë që përpos kufizimit të lirisë, si rezultat i dënimit penal, të dënuarve tu cenohen edhe të drejta të tjera. Për më tepër, vetë ekzekutimi i dënimit me burgim është i shtrejtë, ashtu që krijon barrë të rëndë buxhetore².

Problematikat që shfaqen në raport me dënimin me burgim në asnjë rrethanë nuk duhet ta zbehin rëndësinë e këtij dënimi, si dënimi më klasik dhe më i rëndësishëm në drejtësinë penale. Mirëpo, për shkak të konsekuencave që dënimi me burgim, sidomos në rastet e veprave të lehta penale, shqyrtimi i mundësive për shqiptimin e dënimeve alternative është i rëndësishëm.

Kështu, dënimet alternative janë rezultat i trendeve bashkëkohore. Në brendinë e tyre, këto dënime janë dënime parapenale, me qëllim që në të gjitha rastet e parashikuara me ligj, në vend të dënimit me burgim të shqiptohen dënime alternative. Pra, të shqiptohen dënime jo me burgim³. Këto dënime, synojnë që njëkohësisht të ndëshkojnë kryerësit e veprave penale, por në të njëjtën kohë ti mbajnë ata jashtë burgut⁴.

Urdhri për kryerjen e punëve në dobi të përgjithshme, që është objekt i trajtimit të këtij Manuali, është njëri prej dënimeve alternative. Në mesin e viteve 1960, në Holandë, filluan kritikën ndaj dënimit me burgim. Dy ishin kritikën kryesore. Së pari, përjashtimi dhe stigmatizimi shiheshin si efekte anësore të dënimit me burgim, për të cilin fakt, ky dënim u konsiderua jo human dhe si i tillë duhet të përdorej vetëm në raste të caktuara. Së dyti, ndërkohë që ndahej bindja se si shoqëria ashtu edhe i dënuari përfituan nga rehabilitimi i të dënuarit, kishte një zhgënjim të madh në lidhje me potencialin rehabilitues të dënimit me burgim. Në kuadër të këtij diskutimi, kishte iniciativa për zhvillim-

1 United Nations Office on Drugs and Crime, “*Handbook of basic principles and promising practices on Alternatives to Imprisonment*”, New York, 2007, f.3-6.

2 Po aty.

3 Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, “*Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës*”, Prishtinë, 2014, f. 204.

4 Basharat Hussain, Waheed Chaudhry, Ali Askar, “From Providing ‘Alternative Punishment’ to Offering ‘Punishment in the Community’: The History and Development of Community Penalties in Britain”, ABC Journal of Advanced Research, Volume 1, No 2, 2012, f. 79.

in e formave të reja të dënimeve. Rritja e aplikimit të dënimit me gjobë dhe përdorimi i dënimeve me kusht ishte njëra nga mundësitë që u shqyrtuan. Në këtë klimë diskutimi, u propozua puna e papaguar në dobi të komunitetit, si alternativë e dënimit me burgim. Kështu, puna në dobi të përgjithshme, si lloj i dënimit alternativ, është i kohës relativisht të re. Në kontinentin e Evropës për herë të parë është paraparë në legjislacionin penal të Danimarkës në vitin 1974. Më pas, këtë lloj dënimi e kanë përvetësuar edhe shumë shtete të zhvilluara të Evropës, siç është Franca, Gjermania, Hungaria, Polonia, Finlanda, Çekia, Suedia, Anglia, Irlanda e Veriut etj. Gjithashtu, puna në dobi të përgjithshme është paraparë edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky lloj dënimi është rekomanduar edhe me Rregullat e Evropës (Rekomandimet e Këshillit të Evropës, nr. R(92). Qëllimi i të gjitha shteteve të cilat e kanë paraparë këtë lloj dënimi është që në të gjitha rastet e mundshme të reduktohen dënimet afatshkurtra me burgim⁵.

Qëllimi i urdhrit për punë në dobi të përgjithshme është në linjë me qëllimin e dënimeve alternative. Në këtë rast, duhet theksuar faktin se shqiptimi i këtij dënimi, përtej të qëllimit që ka në raport me sistemin, siç është mos popullimi i burxheve, ruajtja e buxhetit etj., qëllimi i tij është rehabilitimi i kryerësve të veprave penale⁶. Kështu, shqiptimi i këtij dënimi, nuk nënkupton se Gjykatat heqin dorë nga arritja e qëllimit të dënimit. Përkundrazi, në secilin rast kur ligji lë mundësinë e shqiptimit të këtij dënimi, Gjykatat duhet të analizojnë nëse shqiptimi i këtij dënimi mundëson ose jo arritjen e qëllimeve të dënimit. Andaj, jo në secilin rast kur ligjërisht lejohet shqiptimi i këtij dënimi i njëjti duhet të shqiptohet. Kjo duhet të ndodhë vetëm atëherë kur Gjyqtarët binden se shqiptimi i këtij dënimi mundëson arritjen e qëllimeve të dënimit.

Shqiptimi i urdhërit për punë në dobi të përgjithshme ka disa përfitime. Fillimisht, përmes këtij dënimi, Gjykatat mbajnë jashtë burgut kryesit e veprave të lehta penale. Por, mos dërgimi i të dënuarit në burg nuk nënkupton se ai mbetet i padenuar. Por se, ndëshkimi ndaj tij konstiston në obligimin që i njëjti të kryejë punë në dobi të komunitetit. Tutje, shqiptimi i urdhrit për punë në dobi të përgjithshme ul edhe barrën buxhetore për mbajtjen e të burgosurve. Një urdhër i tillë ndihmon po ashtu në rehabilitimin e kryesit të veprës penale, në atë mënyrë që ky dënim ekzekutohet duke ia mundësuar të dënuarit që i njëjti të mbajë lidhjen me familjen dhe të ruaj punën që ka⁷.

Shembuj të punëve që kryhen në kuadër të urdhrit për punë në dobi të përgjithshme janë ndërtimi apo mirëmbajtja e rrugëve publike, punimet e ruajtjes dhe përmirësimit të mjedisit, projektet për ruajtjen, menaxhimin ose shpërndarjen dhe furnizimin e ujit, punën e mirëmbajtjes në shkollat publike, spitalet dhe lehtësitë e tjera publike sociale, ofrimi i mësimdhënies pa pagesë në shkolla pas orarit të rregullt etj⁸.

5 Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, "Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës", Prishtinë, 2014, f. 229-230

6 Basharat Hussain, Waheed Chaudhry, Ali Askar, "From Providing 'Alternative Punishment' to Offering 'Punishment in the Community': The History and Development of Community Penalties in Britain", ABC Journal of Advanced Research, Volume 1, No 2, 2012, f. 83.

7 Penal Reform International, Making Community Service Work: A resource pack from East Africa, London, 2012, f.7.

8 Po aty.

Siç u tha, nevoja për përfitimin e benefiteve të institucioneve nga shqiptimi i urdhrit për punë në dobi të përgjithshme nuk duhet të abstrahojë qëllimin kryesor të dënimit: aritjes së qëllimeve të dënimit. Në fakt, krahas të tjerave, ky duhet të jetë fokusi kryesor me rastin e shqiptimit të këtij urdhri. Kështu, në drejtim të rehabilitimit të të dënuarit, është shumë e rëndësishme që edhe puna që urdhërohet të kryhet, të jetë e individualizuar, në atë mënyrë që edhe lloji i punës që kryhet të synoj rehabilitimin e të dënuarit, duke i krijuar të njëjtit shprehje të mira dhe duke e bërë atë të gatshëm që në shoqëri të kthehet si person i dobishëm.

Edhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Tutje: KPRK), në kuadër të sanksioneve penale, ka përcaktuar dënime alternative. Fillimisht, dënime alternative ishin parashikuar me Kodin e Përkohshëm Penal. Këtu, ishin përcaktuar dy dënime alternative, ai me kusht dhe gjysmë liria⁹. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme ishte përcaktuar si mundësi të shqiptohet vetëm në ndërlidhje me dënimin me kusht, por jo si dënim i vetëm alternativ.

Edhe Kodi Nr.04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës ka përcaktuar dënime alternative. Për dallim nga Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, urdhri për punë në dobi të përgjithshme tanimë përcaktohet si dënim i veçantë alternativ, që jo domosdoshmërisht ndërlidhet me dënimin me kusht. Në mënyrë të njëjtë, dënime alternative janë të trajtuara në Kodin Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, i cili aktualisht është në fuqi.

3 URDHRI PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME SI ZËVENDËSIM I DËNIMIT KRYESOR DHE SI DËNIM ALTERNATIV

Në linjë me rëndësinë dhe qëllimin që ka, në kuadër të sanksioneve penale, KPRK ka përcaktuar edhe udhrin për punë në dobi të përgjithshme. Fillimisht, për ti dhënë kontekst, duhet sqaruar se KPRK ka përcaktuar tri lloje të dënimeve: Kryesore, alternative dhe plotësuese¹⁰. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme na shfaqet tek dy llojet e dënimeve, atyre kryesore dhe atyre alternative.

Në rastin e dënimeve kryesore, urdhri për punë në dobi të përgjithshme paraqitet si mundësi që Gjykata të zëvendësojë dënimin me burgim me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme¹¹. Po ashtu, si pjesë e dispozitave që rregullojnë dënimet kryesore, urdhri për punë në dobi të përgjithshme paraqitet edhe si mundësi e zëvendësimit të dënimit me gjobë¹². Ndërsa, krahas dënimit me kusht dhe gjysmëllirisë, urdhri për punë në dobi të përgjithshme bënë pjesë edhe në kuadër të dënimeve alternative¹³.

Në esencën e saj, pa marrë parasysh se ku kualifikohen, të dy këto dënime janë dënime alternative. Edhe pse ka dy lloj dispozitash në raport me urdhërin për punë në dobi të përgjithshme, përkatësisht ato që këtë urdhër e kategorizojnë si dënim alternative dhe ato që e kategorizojnë si dënim kryesor, përkatësisht si zëvendësim të dënimit kryesor, në të dy rastet, këto dispozita flasin për mundësinë që gjyqtari ti shmangët caktimit të dënimit me burgim dhe/apo me gjobë dhe të shqiptojë dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.

Mirëpo, këto dy kategori të dispozitave lidhur me punën në dobi të përgjithshme nuk janë uniforme. Në vijim, paraqesim tekstin e këtyre dispozitave gjersa në nënkapitujt vijues, ky Manual qartëson mënyrën e aplikimit të urdhrin për punë në dobi të përgjithshme sipas secilës dispozitë.

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme si zëvendësim i dënimit me gjobë

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e personit të dënuar, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme¹⁴.

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme si zëvendësim i dënimit me burgim

Gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund të zëvendësojë dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme¹⁵.

10 Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 39

11 Po aty, neni 45.1.

12 Po aty, neni 43.5.

13 Po aty, neni 57.1.

14 Po aty, neni 43.5.

15 Po aty, neni 45.1.

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme si dënim alternativ

- Gjykata mund t'ia shqiptojë personit të dënuar dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme nëse kryesit i shqipton dënim me gjobë deri në dymijepesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në një (1) vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar¹⁶.

Nga këto dispozita, shihet se kushtet për shqiptimin e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme, nëpër dispozita të ndryshme, nuk janë uniforme. Përderisa në rastin e dënimeve alternative, shqiptimi i urdhrit për punë në dobi të përgjithshme shqiptohet vetëm në rastet kur kryesit i shqipton dënim me burgim deri në një (1) vit, në rastin e zëvendësimit të dënimit me burgim ky urdhër mund të shqiptohet vetëm në rastet kur kryesit i shqiptohet dënim me burgim deri në gjashtë (6) muaj. Ndërsa, në rastin e dënimit me gjobë, urdhri për punë në dobi të përgjithshme si dënim alternativ mund të shqiptohet vetëm në rastet kur kryesit i shqiptohet dënimi me burgim deri në 2.500 euro, derisa si mundësi e zëvendësimit të dënimit me gjobë, lartësia e gjobës nuk caktohet fare. Kështu, këto dispozita nuk janë uniforme, gjersa e përbashkëta e të gjitha këtyre dispozitave është se për shqiptimin e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme kërkohet pëlqimi i personit të dënuar.

Përballë këtij jo uniformiteti, shtrohet pyetja se si do të veprojë gjyqtari në secilin rast. Qartësimi i dispozitave jo uniforme në kuptimin material nënkupton rastet qartësimin mbi kushtet apo rastet se kur mund të shqiptohet urdhri për punë në dobi të përgjithshme.

Fillimisht, duhet theksuar faktin se shqiptimi i urdhrit për punë në dobi të përgjithshme në secilin rast është në favor të të dënuarit. Kjo për dy arsye. E para se ky urdhër i mundëson të dënuarit që në vend mbajtjes së burgimit apo pagesës së gjobës, të kryejë një punë në dobi të përgjithshme. E dyta është se në secilin rast, ky urdhër mund të shqiptohet vetëm me pëlqimin e tij.

Neni 3 i Kodit të Procedurës Penale ka garantuar parimin *in dubio pro reo*. Sipas këtij neni "Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose **për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij** sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës". Kështu, kjo dispozitë hap rrugë që të gjitha mëdyshjet të listuara si më lartë, në lidhje me interpretimin e rasteve se kur mund të shqiptohet urdhri për punë në dobi të përgjithshme të interpretohet në favor të të dënuarit.

Në këtë kuptim, në rastin e dënimit me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjyqtari mund ta shqiptojë urdhrin për punë në dobi të përgjithshme qoftë si dënim alternativ qoftë si zëvendësim i dënimit me burgim. Ndërsa, në rastet kur dënimi i shqiptuar është deri në një (1) vit burgim, gjyqtari mundet që urdhrin për punë në dobi të përgjithshme ta shqiptojë si dënim alternativ.

Në rastin e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme si zëvendësim i dënimit me gjobë, KPRK nuk përcakton limit të dënimit me gjobë për rastet se kur mund të aplikohet dënimi me gjobë. Por, kjo nuk nënkupton se cilido dënim me gjobë, pa marrë parasysh lartësinë e tij, mund të zëvendësohet me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. Në rastin e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme si zëvendësim të dënimit me gjobë, KPRK ka përcaktuar se “Urdhri për punë në dobi të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzet (20) Euro gjobë. Kohëzgjatja e punës në dobi të përgjithshme nuk mund të tejkalojë dyqind e dyzet (240) orë pune”. Sipas përlllogaritjes matematikore, i dënuari ka mundësi që përmes urdhrit për punë në dobi të përgjithshme të zëvendësojë maksimalisht gjobën deri në 600 euro.

Në këtë situatë, në rastin e dënimit me gjobë deri në 600 euro, gjyqtari mund ta shqiptojë urdhrin për punë në dobi të përgjithshme qoftë si zëvendësim të dënimit me gjobë qoftë si dënim alternativ. Ndërsa, në rastin e dënimit mbi gjobë mbi 600 e deri në 2500 euro, gjyqtari mund të shqiptojë urdhrin për punë në dobi të përgjithshme si dënim alternativ.

Në linjë me nenin 3 të Kodit NR. 08/L-032 të Procedurës Penale, urdhri për punë në dobi të përgjithshme si dënim alternativ mund të shqiptohet edhe në rastet kur gjykata shqipton kumulativisht dënimin me burgim deri në një (1) vit dhe dënimin me gjobë deri në 2.500 euro.

Duhet theksuar faktin se të gjitha këto raste paraqesin mundësi për gjyqtarin dhe në asnjë rrethanë obligim për të. Kështu, aplikimin e këtyre mundësive, gjyqtari në secilin rast duhet ta shqyrtojë në dritën e qëllimeve të dënimit dhe vetëm nëse vlerëson se urdhri për punë në dobi të përgjithshme përmbushë synimet për arritjen e qëllimit të dënimit atëherë ai shqipton këtë urdhër në vend të dënimit me burgim apo atij me gjobë.

Në vijim të këtij manuali, do të elaborohet në detaje mënyra e marrjes së pëlqimit në rastin e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme si zëvendësim i dënimit me burgim dhe me gjobë apo si dënim alternativ.

4 URDHRI PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME TEK TË RRRITURIT SI ZËVENDËSIM I DËNIMIT KRYESOR

Në rastin e procedurave penale kur të pandehurit janë të rritur, urdhri për punë në dobi të përgjithshme si zëvendësim i dënimit me burgim shqiptohet sipas nenit 45 të KPRK. Ndërsa, urdhri për punë në dobi të përgjithshme si zëvendësim i dënimit me gjobë shqiptohet sipas nenit 43.5. të KPRK.

Rastet kur lejohet shqiptimi i urdhrin për punë në dobi të përgjithshme

Si zëvendësim i dënimit kryesor

Për tu shqiptuar urdhri për punë në dobi të përgjithshme si zëvendësim i dënimit me burgim, dënimi i shqiptuar nga gjykata nuk duhet të jetë më i lartë se gjashtë (6) muaj¹⁷.

Ndërsa, për tu shqiptuar urdhri për punë në dobi të përgjithshme si zëvendësim i dënimit me gjobë, dënimi i shqiptuar nga gjykata nuk duhet të jetë më i lartë se 600 euro¹⁸.

Si dënim alternativ

Për tu shqiptuar urdhri për punë në dobi të përgjithshme si dënim alternativ, dënimi i shqiptuar nga Gjykata nuk duhet të jetë më i lartë se një (1) vit burgim ndërsa gjoba nuk duhet të jetë më e lartë se 2.500 euro¹⁹.

Marrja e pëlqimit

Në të gjitha rastet, urdhri për punë në dobi të përgjithshme mund të shqiptohet vetëm nëse Gjykata merr pëlqimin e të dënuarit për këtë zëvendësim.

Proceduralisht, gjatë fazës së shqyrtimit të rastit, Gjykata nuk mund të shqyrtojë marrjen e pëlqimit nga ana e të pandehurit. Kjo për faktin se kjo do të cenonte parimin e prezumimit të pafajësisë së të pandehurit, shqyrtimit i fajësisë së të cilit është në proces i sipër.

Marrja e pëlqimit nga i pandehuri për shqiptimin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme mund të bëhet në dy (2) momente procedurale, të cilat vijnë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor: Seanca për caktimin e dënimit pas pranimit të fajësisë²⁰ apo aktgjykimit dënues apo gjatë shpalljes së aktgjykimit. Në këtë situatë, proceduralisht, në rastet kur gjykata vlerëson se ka mundësi të aplikoj urdhrin për punë në dobi të

17 Po aty, neni 45.1.

18 Po aty, neni 43.5.

19 Po aty, neni 57.1.

20 Kodi NR. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 356.

përgjithshme dhe ky dënim është adekuat për arritjen e qëllimeve të dënimit, atëherë gjykata mund ta marrë pëlqimin e të pandehurit gjatë mbajtjes së seancës për caktimin e dënimit pas pranimit të fajësisë apo aktgjykimit dënues apo me rastin e shpalljes së aktgjykimit. Kështu, paraprakisht, gjykata shqipton dënimin ndaj të pandehurit, e më pastaj kërkon nga i pandehuri që të deklarohet nëse jep pëlqimin e tij që ky dënim të zëvendësohet me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme.

Duhet theksuar faktin se shpallja e aktgjykimit bëhet edhe nëse i pandehuri nuk merr pjesë në seancën e shpalljes së aktgjykimit²¹. Nëse me rastin e shpalljes së aktgjykimit i dënuari nuk merr pjesë, atëherë më nuk ka fazë procedurale se kur gjykata mund ta marrë pëlqimin e të pandehurit. Kështu, në këtë situatë, pamundësohet shqiptimi i urdhrin për punë në dobi të përgjithshme.

Dhënia e pëlqimit nga i dënuari për zëvendësimin e dënimit me burgim apo me gjobë në urdhër për punë në dobi të përgjithshme nuk paraqet pranim të fajësisë. Për këtë arsye, neni 383 i Kodit NR. 08/L-032 të Procedurës Penale nuk paraqitet si pengesë në këto raste që i pandehuri të paraqesë ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Kohëzgjatja e urdhrin

Nëse gjyqtari, me pëlqimin e të dënuarit, vendos që të shqiptojë urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, atëherë gjyqtari duhet të vendosë se sa orë i dënuari duhet të kryejë punë në dobi të përgjithshme dhe brenda cilit interval kohor duhet ti kryejë këto orë të punës.

Numri i orëve të punës në dobi të përgjithshme nuk mund të jetë më pak se 30 e as më shumë se 240 orë pune. Po ashtu, në aktgjykim, gjyqtari duhet të vendosë edhe periudhën kohore brenda të cilës i dënuari duhet të kryejë orët e punës së caktuar nga Gjykata. Periudha kohore brenda të cilës i dënuari duhet të kryejë këto orë pune nuk mund të jetë më e gjatë se 1 vit²².

Përpos këtyre limiteve, gjyqtari nuk ka limite të tjera në lidhje me numrin e orëve të punës në dobi të përgjithshme që obligohet ti kryej i dënuari e as në lidhje me intervalin kohor brenda të cilit i dënuari duhet ti kryejë këto orë të punës në dobi të përgjithshme. Kështu, duke u bazuar në rrethanat e rastit, karakteristikat e të dënuarit etj. gjyqtari duhet të vlerësoj se sa orë pune në dobi të përgjithshme duhet të kryej i dënuari dhe brenda cilit interval kohor, që të arrihen qëllimet e dënimit. Me këtë rast, përfitimin publik nga puna në dobi të përgjithshme gjyqtari duhet ta konsiderojë si diçka sekondare. Primare duhet të jenë qëllimet e dënimit, kryesori prej të cilëve parandalimi i kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij. Situatë identike është edhe kur urdhri për punë në dobi të përgjithshme shqiptohet si

21 Kodi NR. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 365.4.

22 Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 45.

zëvendësim i dënimit me gjobë. Vetëm se, në këto situata, numri i orëve të punës në dobi të përgjithshme duhet të ndërlidhet me lartësinë e gjobës. Sipas KPRK²³, në këto raste, një ditë pune prej tetë (8) orëve vlerësohet me 20 euro. Matematikisht i bie se gjyqtari duhet të vlerësojë një orë pune me 2.5 euro dhe numri i orëve të punës duhet të korrespondojë me lartësinë e gjobës.

5 REVOKIMI I URDHËRIT

përgjithshme atëherë Gjykata do të revokoj këtë urdhër, sipas procedurës së elaboruar në kapitullin 8 të këtij Manuali.

Me rastin e revokimit të urdhrit, në rastet kur urdhëri është shqiptuar si zëvendësim i dënimit me burgim apo atij me gjobë, nuk merret parasysh dënimi i cili është zëvendësuar me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. Thënë më ndryshe, nëse i pandehuri është dënuar me 6 muaj burgim efektiv dhe ky dënim është zëvendësuar në urdhër për punë në dobi të përgjithshme, me rastin e revokimit të dënimit, nuk duhet nënkuptuar se të pandehurit do të rikthehet dënimi me gjashtë (6) muaj burgim efektiv. Por, në këto raste, relevante janë numri i orëve të punës në dobi të përgjithshme, të cilat i dënuari nuk i ka kryer. Sipas KPRK²⁴, Një ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer. Kështu, ta zëmë, nëse i dënuari ka qenë i obliguar ti kryejë 100 orë pune ndërsa ka kryer vetëm 20 prej tyre, gjykata do të urdhërojë dënimin me burgim për 80 orët e punës së pakryer, që në rastin konkret i bie të jenë 10 ditë burgim efektiv.

Ndërsa, KPRK nuk ka ndonjë dispozitë specifike në lidhje me rastet kur të dënuarit i është zëvendësuar dënimi me gjobë në urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Në këto raste, në kuptim të parimit in dubio pro reo, nuk duhet nënkuptuar se aplikohet dispozita sipas të cilës ndaj të dënuarit do të obligohet burgimi. Një interpretim i tillë analog nuk shkon në dobi të të pandehurit pasi ky interpretim do ta vështirësonte pozitën e të pandehurit që ka pasur edhe para zëvendësimit të dënimit me gjobë në urdhër për punë në dobi të përgjithshme, nëse ndaj tij do të urdhërohej burgimi efektiv.

Kështu, në rastet e mos kryerjes së punëve në dobi të përgjithshme sipas urdhrit për punë në dobi të përgjithshme, në të cilin është zëvendësuar dënimi me gjobë, Gjykata duhet të urdhërojë që i dënuari të paguajë gjobën, ku për çdo tetë (8) orë pune të pakryer, Gjykata do të caktojë gjobë në vlerë prej 20 euro.

Ndërsa, nëse i pandehuri nuk e paguan as gjobën, atëherë dënimi me gjobë ekzekutohet nga Gjykata, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Kapitullin III të Ligjit NR. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Pra, borxhi që derivon nga gjoba e shqiptuar, përmbahet sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

23 Po aty, neni 43.5.

24 Po aty, neni 45.4.

Mirëpo, me rastin e caktimit të dënimit me gjobë, Gjykata mund ta aplikojë edhe nenin 43.3. të KPRK i cili përcakton se “Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënimin me burgim, njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet”. Mirëpo, aplikimi i kësaj dispozite duhet të jetë i përcaktuar paraprakisht nga gjykata në aktgjykim. Thënë më ndryshe, nëse aplikimi i këtij neni nuk është i përcaktuar në aktgjykim në rastet e dënimit me gjobë, gjoba ekzekutohet sipas dispozitave të Ligjit për Procedurë Përmbartimore, derisa nëse aplikimi i kësaj dispozite theksohet në aktgjykim, atëherë dënimi me gjobë shndërrohet proporcionalisht në dënim me burgim.

6 URDHRI PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME TEK TË MITURIT

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme paraqitet edhe në rastet penale ndaj të miturve. Procedurat penale ndaj të miturve, për shkak të specifikave që kanë të miturit, janë procedura të veçanta. Në këto raste, interesi më i mirë i fëmijëve të përfshirë në këto procedura penale është qëllimi kryesor i procedurës penale. Këto specifika reflektohen edhe në urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. Specifika në këtë drejtim shfaqen si në raport me shqiptimit të këtij urdhri ashtu edhe në raport me ekzekutimin e tij.

Legjislacioni bazik penal në rastet e të miturve është Kodi NR. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur. Në këtë Kod bëjnë pjesë edhe dispozitat që kanë të bëjnë me shqiptimin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme ndaj të miturve dhe ekzekutimin e këtij urdhri në këto raste.

Sikurse në rastin e legjislacionit penal për të rriturit, edhe në rastin e Kodit NR. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur urdhri për punë në dobi të përgjithshme parashihet në forma të ndryshme. Në rastin e të miturve, Kodi NR. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur e parasheh urdhrin për punë në dobi të përgjithshme si masë të diversitetit si dhe urdhrin për punë në dobi të përgjithshme si dënim. Për më tepër, në rastet ndaj të miturve, urdhri për punë në dobi të përgjithshme paraqitet edhe si mundësi e zëvendësimit të dënimit me gjobë.

Nisur nga specifikat e procedurës penale ndaj të miturve, implikimet e këtyre dallimeve në mes të urdhrin për punë në dobi të përgjithshme si masë e diversitetit, dënim dhe mundësi për zëvendësimin e dënimit me gjobë janë më të theksuara. Andaj, në vijim të këtij Manuali, urdhri për punë në dobi të përgjithshme si masë e diversitetit, si dënim dhe si mundësi për zëvendësimin e dënimit me gjobë, për shkak të qartësisë, do të trajtohen ndaras.

Puna në dobi të përgjithshme si masë e diversitetit

Sipas Kodit NR. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur, masat e diversitetit kanë për qëllim që të parandalojë, kur është e mundur, fillimin e procedurës gjyësore ndaj kryerësit të mitur, të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste²⁵. Kodi NR. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur ka përcaktuar gjithsej 16 masa të diversitetit që mund të shqiptohen ndaj të miturit. Në kuadër të këtyre masave hyn edhe kryerja e punëve në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësitë e kryesit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Masat e diversitetit

shqiptohen nga ana e Prokurorit të Shtetit²⁶. Masa për kryerjen e punëve në dobi të përgjithshme mund të shqiptohet krahas masave të tjerave të diversitetit, sipas specifikave të secilit rast dhe vlerësimit të Prokurorit të Shtetit²⁷.

--→ Kushtet për shqiptimin e urdhrit për punë në dobi

Puna në dobi të përgjithshme si masë e diversitetit mund të shqiptohet ndaj të miturit i cili ka mbushur 14 vjet por nuk ka mbushur 18 vjet²⁸.

Kjo masë mund të shqiptohet për veprat penale të dënueshme deri në tri (3) vite burgim. Në rastin e veprave penale të kryera nga pakujdesia, ky urdhër mund të shqiptohet edhe për veprat penale të dënueshme deri në pesë (5) vite burgim, me përjashtim të veprave penale që si pasojë kanë vdekjen²⁹.

Për tu shqiptuar puna në dobi të përgjithshme si masë e diversitetit, duhet të plotësohen kushtet për shqiptimin e masave të diversitetit, e që janë:

- 1] Pranimi i përgjegjësisë për veprën penale nga i mituri;
- 2] Shprehja e gatishmërisë nga i mituri që të pajtohet me palën e dëmtuar dhe;
- 3] Pëlqimi i të miturit ose i prindit, prindit adoptues ose kujdestarit në emër të të miturit për të zbatuar masën e shqiptuar të diversitetit.

Kriteri i tretë, pëlqimi, në rastin e masës së diversitetit për punë në dobi të përgjithshme duhet të ipet vetëm nga i mituri. Pra, prindi, prindi adoptues ose kujdestari nuk mund që në emër të të miturit të jap pëlqimin për shqiptimin e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme si masë e diversitetit³⁰.

Nëse këto kushte plotësohen në mënyrë kumulative, Prokurori i Shtetit mund të shqiptojë masën e diversitetit për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme dhe të vendosë mos të fillojë procedurën penale.

--→ Kohëzgjatja e masës

Me rastin e shqiptimit të masës së diversitetit për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme, Prokurori i Shtetit duhet të vendosë edhe për kohëzgjatjen e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme. Përkatësisht, Prokurori i Shtetit duhet caktojë numrin e orëve të punës që duhet ti kryejë i mituri si dhe intervalin kohor brenda të cilit duhet të kryhen këto orë pune.

Numri i orëve të punës në dobi të përgjithshme nuk mund të jetë më i ulët se 10 orë pune dhe as më i lartë se 60 orë pune. Brenda këtyre limiteve, Prokurori i Shtetit do të ven-

26 Shënim: Këtu bënë përjashtim vetëm vërejtja policore si masë e diversitetit, e cila shqiptohet nga ana e zyrtarit policor, me lejen e Prokurorit të Shtetit për të mitur. Kodi NR. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, neni 21, par. 2 dhe 3.

27 Kodi NR.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, neni 20.

28 Kodi NR. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, neni 20.1. lidhur me nenin 3.1.1.2.

29 Po tay, neni 21.2.

30 Po aty, neni 20.1.1.6.

dosë duke pasur parasysh rrethanat specifike të secilit rast, gjithnjë duke synuar që kjo masë ti shërbejë të miturit në rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e tij në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste³¹.

Lidhur me intervalin kohor brenda të cilit duhet të kryhen këto orë të punës, Kodi NR. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur nuk parasheh ndonjë dispozitë. Në këtë rast, si pikë referente mund të jetë dispozita që flet lidhur me intervalin kohor të urdhrit për punë në dobi të përgjithshme si dënim, e cila mund të aplikohet nga Prokurori i Shtetit. Kështu, me rastin e shqiptimit të masës së diversitetit për kryerjen e punëve në dobi të përgjithshme, Prokurori i Shtetit duhet të vendosë edhe intervalin kohor brenda të cilit duhet të kryhen orët e punës në dobi të përgjithshme, i cili interval kohor nuk mund të jetë më i gjatë se një (1) vit³².

--→ Revokimi i masës

Nëse i mituri nuk përmbushë orët e punës në dobi të përgjithshme sipas masës së diversitetit të caktuar nga e Prokurorit të Shtetit, Shërbimi Sprovues e informon menjëherë Prokurorin e Shtetit për moskryerjen e detyrimeve nga i mituri. Nëse kjo ndodhë, atëherë Prokurori i Shtetit mund të vendosë që të rifillojë procedurën e rregullt penale³³.

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme si dënim

Përpos si masë e diversitetit, urdhri për punë në dobi të përgjithshme, krahas gjobës dhe burgimit për të mitur, paraqitet edhe si dënim për të miturit. Kështu, për dallim nga puna në dobi të përgjithshme si masë e diversitetit, urdhri për punë në dobi të përgjithshme në këtë rast paraqitet si dënim ndaj të miturit i cili ka kryer vepër penale. Kështu, si dënim, ky urdhër shqiptohet nga Gjykata, sipas propozimit të Prokurorit të Shtetit, në rastet kur Gjykata konstaton fajësinë e të miturit për kryerje të veprës penale³⁴.

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme, si dënim, paraqitet në dy (2) forma: si dënim dhe si zëvendësim i masës edukative intitucionale, burgimit për të mitur apo dënimin me gjobë³⁵. Të gjitha këto forma të paraqitjes së urdhrit për punë në dobi të përgjithshme kanë specifikat e saja, të cilat do të elaborohen në vijim.

Kushtet për shqiptimin e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme si dënim mund të shqiptohet nga Gjykata, në secilin rast, vetëm ndaj të miturit i cili ka mbushur 16 vjet dhe nuk ka mbushur 18 vjet. Pra, për dallim nga puna në dobi të përgjithshme si masë e diversitetit, urdhri për punë në dobi të përgjithshme si dënim nuk mund të shqiptohet për të miturit nga 14 deri në 16 vjet³⁶.

31 Po aty, neni 20.1.1.6, lidhur me nenin 19.

32 Po aty, neni 32.5.

33 Po aty, neni 21.5.

34 Po aty, neni 12.2. dhe 32

35 Po aty, neni 32.

36 Po aty, neni 12, par. 2 dhe 3.

Sa i përket kritereve që duhet të plotësohen për shqiptimin e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme nga Gjykata, ka një dallim në mes të rasteve kur ky urdhër shqiptohet drejt për drejt si dënim në raport me rastet kur ky urdhër shqiptohet si zëvendësim i masës edukative institucionale, burgimit për të mitur apo gjobës.

--→ Kur shqiptohet drejt për drejt si dënim

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme, për dallim nga madhorët, nuk shfaqet si dënim alternativ, por si dënim, ta quajmë kryesor. Kjo nënkupton se shqiptimit të këtij urdhri nuk i paraprinë shqiptimi i një dënim nga Gjykata, por ky urdhër shqiptohet drejt për së drejti si dënim.

Për dallim nga të gjitha rastet e tjera, në rastet kur Gjykata e shqipton këtë urdhër si dënim ndaj të miturit, Kodi NR. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur nuk kërkon pëlqimin e të miturit³⁷. Kjo ndërlidhet edhe me qëllimet që ka dënimi në rastin e të miturve, që është interesi më i lartë i të miturve. Kështu, nëse Gjykata vlerëson se arritja e qëllimit të dënimit për të mitur realizohet më së miri nëse i mituri obligohet që të kryejë punë në dobi të përgjithshme, atëherë Gjykata mund të vendosë që të obligojë të miturit që të kryejë punë në dobi të përgjithshme, përmes këtij urdhri, edhe pa pëlqimin e tij. Kuptohet, duke pasur parasysh specifikat e secilit rast dhe secilit të mitur.

Sa i përket rasteve kur mund të shqiptohet ky dënim, Kodi NR. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur nuk paraqet asnjë kufizim. Pra, Gjykata mundet që për çfarëdo vepre penale, ta shqiptojë urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, në rastet kur këtë dënim e vlerëson si adekuat.

--→ Kur shqiptohet si zëvendësim i masës edukative institucionale

Në rastet kur Gjykata shqipton masën edukative institucionale deri në tri (3) vjet, ajo mund ta zëvendësojë këtë masë me urdhërin për punë në dobi të përgjithshme. Zëvendësimi i masës edukative institucionale në urdhër për punë në dobi të përgjithshme mund të bëhet vetëm nëse i mituri pajtohet për këtë zëvendësim³⁸.

--→ Kur shqiptohet si zëvendësim i burgimit për të mitur

Në rastet kur Gjykata shqipton burgim për të miturit deri në dy (2) vjet, ajo mund ta zëvendësojë këtë dënim me urdhërin për punë në dobi të përgjithshme. Zëvendësimi i burgimit për të mitur në urdhër për punë në dobi të përgjithshme mund të bëhet vetëm nëse i mituri pajtohet për këtë zëvendësim³⁹.

--→ Kur shqiptohet si zëvendësim i dënimit me gjobë

Edhe në rastet kur urdhri për punë në dobi të përgjithshme shqiptohet si zëvendësim i dënimit me gjobë na paraqiten dy (2) situata të ndryshme: Kur ky urdhër shqiptohet si zëvendësim i dënimit me gjobë në momentin e shqiptimit të dënimit dhe kur ky urdhër shqiptohet si zëvendësim i dënimit me gjobë në rastet kur i mituri nuk e paguan gjobën e shqiptuar.

37 Po aty, neni 32.

38 Po aty, neni 32.2.

39 Po aty.

--→ Kur urdhri shqiptohet si zëvendësim i dënimit të shqiptuar

Në rastet kur Gjykata i shqipton të miturit dënim me gjobë, ajo mund ta zëvendësojë këtë dënim me urdhërin për punë në dobi të përgjithshme. Zëvendësimi i dënimit me gjobë në urdhër për punë në dobi të përgjithshme mund të bëhet vetëm nëse i mituri pajtohet për këtë zëvendësim. Nuk ka dispozitë që përcakton se cila është lartësia e dënimit të të miturit me gjobë e cila mund të zëvendësohet nga Gjykata. Andaj, Gjykata me pëlqimin e të miturit, varësisht specifikave të rastit, mund ta zëvendësojë secilin dënim me gjobë, pa marrë parasysh lartësinë e tij, me urdhërin për punë në dobi të përgjithshme⁴⁰.

--→ Kur urdhri shqiptohet si zëvendësim i dënimit të papaguar

Për dallim nga rastit kur urdhri për punë në dobi të përgjithshme paraqitet si zëvendësim i dënimit me gjobë të shqiptuar nga Gjykata, si zëvendësim i dënimit të papaguar, urdhri për punë në dobi të përgjithshme paraqitet pas përfundimit të procedurës penale ndaj të miturit.

Nëse i mituri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata fillimisht do të mundësojë të miturit që gjobën ta paguajë me këste, por jo më gjatë se dy (2) vjet. Nëse pas kësaj mundësie të dhënë, i mituri përsëri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund ta zëvendësojë gjobën me urdhër për punë në dobi të përgjithshme që nuk pengon vijimin e rregullt në shkollë dhe aktivitetet tjera të punës.

Kohëzgjatja e urdhrit

Me rastin e shqiptimit të urdhrit për punë në dobi të përgjithshme, Gjykata duhet të caktojë numrin e orëve të punës që i mituri duhet të kryejë si dhe intervalin kohor brenda të cilit duhet të kryhen orët e punës.

Duke pasur parasysh specifikat e rastit dhe të të miturit, Gjykata do të vendosë për numrin e orëve të punës që duhet ti kryejë i mituri. Numri i orëve të punës në dobi të përgjithshme që Gjykata do ta urdhërojë të miturin ti kryejë nuk mund të jetë nën 30 orë punë dhe as mbi 120 orë punë⁴¹.

Ndërsa, Gjykata duhet po ashtu të vendosë edhe për intervalin kohor brenda të cilit i mituri duhet të kryejë numrin e orëve të punës të caktuara nga Gjykata. Ky interval kohor maksimumi mund të jetë një (1) vit⁴².

Revokimi i urdhrit

Nëse i mituri nuk i përmbahet urdhrit për punë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron ekzekutimin e burgimit për të mitur në kohëzgjatje proporcionale, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e punës në dobi të përgjithshme që është kryer⁴³.

40 Po aty, neni 32.2.

41 Po aty, neni 32.1.

42 Po aty, neni 32.5.

43 Po aty, neni 32.6.

Procedura penale për revokimin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme tek të rriturit aplikohet përshtatshmërisht edhe për revokimin e këtij urdhri në rastin e të miturve⁴⁴.

Ekzekutimi i urdhrin

Dispozitat që rregullojnë ekzekutimin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme ndaj të rriturve zbatohen përshtatshmërisht edhe në rastin e ekzekutimit të këtij urdhri ndaj të miturve⁴⁵.

Por, ekzekutimi i urdhrin për punë në dobi të përgjithshme në rastin e të miturve ka disa specifika. Fillimisht, duhet theksuar se në rastin e ekzekutimit të këtij urdhri ndaj të miturve, kujdes i veçantë duhet kushtuar që puna në dobi të përgjithshme të mos pengojë vijimin e rregullt në shkollë ose aktivitetet tjera të rëndësishme. Ndërsa, nëse është në interes të të miturit, shërbimi sprovues mund të kërkojë ndihmë apo bashkëpunim me organin e kujdestarisë apo përfaqësuesin ligjor të të miturit⁴⁶.

Për çfarëdo pengese që haset gjatë ekzekutimit të urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, Shërbimi Sprovues e njofton Gjykatën pëmes raportit me shkrim. Nëse i mituri nuk mund të kryejë punën në dobi të përgjithshme për shkak të ndryshimit të mëvonshëm të rrethanave për të cilat ai nuk është përgjegjës, shërbimi sprovues nga gjykata kërkon rishqyrtimin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. Varësisht nga rezultatet e arritura, gjykata mund ta ndryshojë urdhrin apo ta pushojë ekzekutimin e masës⁴⁷.

Në këtë mënyrë, në rastin e të miturve, Kodi NR. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur ka paraparë një qasje pro aktive si të Shërbimit Sprovues ashtu edhe të Gjykatës me rastin e ekzekutimit të urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. Kjo në mënyrë që këto institucione edhe gjatë ekzekutimit të këtij urdhri të kujdesen vazhdimisht që i njëjti të maksimalizojë interesin e të miturit.

44 Po aty, neni 6.

45 Po aty, neni 97.1.

46 Po aty, neni 97, par.2 dhe 3.

47 Po aty, neni 97, par. 4-6.

7 ZBATIMI DHE MBIKËQYRJA E UDRHIT PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

Pas shqiptimit të urdhrin për punë në dobi të përgjithshme nga ana e Gjykatës, kompetente për zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtij urdhri është Shërbimi Sprovues i Republikës së Kosovës. Dispozitat që kanë të bëjnë me ekzekutimin e këtij urdhri janë pjesë e Ligjit NR. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Ekzekutimi i urdhrin për punë në dobi të përgjithshme

Kur gjykata shqipton dënimin me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme ajo ia dërgon menjëherë aktgjykimin me të gjitha të dhënat që i posedon shërbimit sprovues kompetent për ekzekutimin e këtij dënimi alternativ⁴⁸.

Pasi që ta zhvilloj programin e punës në dobi të përgjithshme, Shërbimi Sprovues mbikëqyrë ekzekutimin e dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Nëse personi i dënuar nuk mban kontakt me shërbimin sprovues, ose nuk e përmbush obligimin e urdhëruar nga gjykata, shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mosmbajtjen e kontaktit, apo mos përmbushjen e obligimit⁴⁹.

Organet e administratës të nivelit qendror dhe lokal, institucionet dhe personat e tjerë juridik, si dhe personat fizik janë të obliguar të bashkëpunojnë me shërbimin sprovues dhe zyret regjionale sprovuese në ekzekutimin e dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Me qëllim të ekzekutimit të këtij dënimi, Ministri i Drejtësisë lidhë marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione⁵⁰.

Nëse i dënuari nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme në mënyrë të kënaqshme, që nënkupton nënkupton ardhjen e vonuar në punë, mungesat e palejuara nga puna, mosrespektimin e rregullave të punës, atëherë organizata ku i dënuari është duke kryer punën e dobi të përgjithshme e njofton Shërbimin Sprovues. Nëse Shërbimi Sprovues e vlerëson se kemi të bëjmë me mos kryerje në nivel të kënaqshëm të punës në dobi të përgjithshme, atëherë ky institucion për këtë e njofton Gjykatën⁵¹.

Përfundimi i suksesshëm i punës në dobi të përgjithshme i raportohet gjykatës nga shërbimi sprovues. Pas pranimit të raportit të tillë, gjykata merr vendim me të cilin vërtetohet mbajtja e dënimit alternativ. Një kopje e vendimit i dërgohet Shërbimit Sprovues⁵².

Programi i punës në dobi të përgjithshme

Me rastin e shqiptimit të urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, Gjykata cakton numrin e orëve që i dënuari duhet të kryejë si dhe intervalin kohor brenda të cilave duhet të kryhet puna në dobi të përgjithshme. Siç u elaborua, Gjykata me rastin e vendosjes duhet të synojë arritjen e qëllimeve të dënimit.

48 Ligi NR. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 146.1.

49 Po aty, neni 147 dhe 148.

50 Po aty, neni 148.

51 Po aty, neni 149.

52 Po tay, neni 151.

Mirëpo, pas vendimit të Gjykatës, Shërbimi Sprovues i Kosovës duhet të caktojë programin e punës në dobi të përgjithshme. Një nga parakushtet e rëndësishme në masat e kësaj natyre, siç është urdhri për punë në dobi të përgjithshme, është zgjedhja e programit të përshtatshëm në bazë të nevojave dhe vlerësimit të rrezikut, nga i cili mund të përfitojnë të dënuarit. Ajo çfarë synohet të arrihet nëpërmjet këtij programi është, krahas të tjerave, rehabilitimi i kryerësve të veprave penale⁵³.

Sipas Ligjit, Shërbimi Sprovues e zhvillon programin për punë në dobi të përgjithshme për personin e dënuar në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës dhe bazuar në aftësitë, shkathtësitë dhe të kaluarën e tij⁵⁴. Kështu, nuk ka një program uniform dhe as shabllon për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme. Programi duhet të caktohet nga Shërbimi Sprovues rast pas rasti. Duke u bazuar në aftësitë, shkathtësitë dhe të kaluarën e të dënuarit, Shërbimi Sprovues duhet të caktojë një program adekuat të punës në dobi të përgjithshme, duke synuar arritjen e qëllimeve të dënimit. Pra, secilit program për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme duhet ti paraprijë një analizë e specifikave të të dënuarit.

Duhet theksuar se mund të shfaqen situata kur Shërbimi Sprovues duhet të ndryshojë programin për punë në dobi të përgjithshme të cilin e ka zhvilluar për të dënuarin. Nëse personi i dënuar është i paaftë për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme për shkak të rrethanave të ndryshuara, shërbimi sprovues mund të korrigjojë programin për punën në dobi të përgjithshme⁵⁵.

Në anën tjetër, Ligji njuh edhe rrethanat se kur ekzekutimi i urdhrin për punë në dobi të përgjithshme mund të shtyhet apo pezullohet. Kjo mund të ndodhë për shkak të: 1) sëmundjes së papritur të personit të dënuar, e cila kërkon trajtim mjekësor dhe atij ia pamundëson kryerjen e punës në dobi të përgjithshme; 2) vdekjes së ndonjë anëtari të familjes, që atë e obligon të merr rolin e kujdestarit kryesor ndaj anëtarëve të tjerë të familjes dhe ia pamundëson kryerjen e punës në dobi të përgjithshme dhe 3) rrethanave të tjera të jashtëzakonshme, të cilat kërkojnë praninë e përhershme të personit të dënuar për arsye humanitare dhe atij ia pamundësojnë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme⁵⁶.

Kërkesa për shtyrjen, apo pezullimin e ekzekutimit të urdhrin për punë në dobi të përgjithshme mund t'i paraqitet gjykatës nga personi i dënuar, mbrojtësi, ose përfaqësuesi i shërbimit sprovues. Parashtrimi i kërkesës pezullon obligimin për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme derisa gjykata të vendos lidhur me kërkesën⁵⁷.

Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata vendos brenda tri (3) ditëve. Nëse kërkesa aprovet, përcaktohet edhe periudha e shtyerjes apo pezullimit, e cila mund të zgjasë: deri në shërimin e sëmundjes apo deri në njëzet ditë në rastet e vdekjes së ndonjë anëtari të familjes apo rrethanave të jashtëzakonshme⁵⁸.

53 Basharat Hussain, Waheed Chaudhry, Ali Askar, "From Providing 'Alternative Punishment' to Offering 'Punishment in the Community': The History and Development of Community Penalties in Britain", ABC Journal of Advanced Research, Volume 1, No 2, 2012, f. 83.

54 Ligji NR. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 147.1.

55 Po aty, neni 150.1.

56 Po aty, neni 150.2.

57 Po aty, neni 150.3.

58 Po aty, neni 150, par 4 dhe 5.

8 PROCEDURA PËR REVOKIMIN E URDRIT PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

Kapitulli XXXIV i Kodit NR. 08/L-032 të Procedurës Penale, që përmban vetëm një nen [519], flet për procedurën për revokimin e dënimeve alternative. Emërtimi i këtij kapitulli të Kodit është “Procedura për revokimin e dënimeve alternative” derisa emërtimi i nenit 519 është “Kushtet për revokimin e dënimeve alternative”.

Megjithatë, përkundër që Kodi Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës [neni 46.1.] njeh tri (3) dënimet alternative (1. dënimi me kusht, 2. gjysmëlibria dhe 3. urdhri për punë në dobi të përgjithshme) materia e nenit 519 të Kodit NR. 08/L-032 të Procedurës Penale i referohet vetëm dënimit me kusht. Madje, të gjitha nenet në të cilat referohet përmbajtja e këtij neni kanë të bëjnë vetëm me dënimin me kusht dhe jo edhe me dy (2) llojet e tjera të dënimeve alternative, gjysmëlibrisë dhe urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. Ndërsa, përkundër që Kodi Nr.06/L-074 Penal përcakton rastet se kur revokohet urdhri për punë në dobi të përgjithshme, të cilat janë elaboruar në kapitujt tjerë të këtij Manuali, Kodi NR. 08/L-032 i Procedurës Penale nuk ka ndonjë nen tjetër që përcakton procedurën për revokimin e këtij urdhri.

Në këtë situatë, duket se në rastin konkret kemi të bëjmë me një lëshim të Kodit NR. 08/L-032 të Procedurës Penale, i cili përkundër se si në emërtimin e kapitullit ashtu edhe të nenit i është referuar të gjitha dënimeve alternative, materia e nenit i është referuar vetëm dënimit me kusht.

Nisur nga vetë emërtimi i kapitullit XXXIV të Kodit NR. 08/L-032 të Procedurës Penale, emërtimi i nenit 519 të këtij Kodi, mungesës së një dispozite tjetër të kësaj natyre dhe ekzistenës së dispozitave materiale të cilat i referohet rasteve kur urdhri për punë në dobi të përgjithshme revokohet, deri në ndryshimin e kodit, dispozita e nenit 519 të Kodit NR. 08/L-032 të Procedurës Penale duhet të aplikohet përshtatshmërisht edhe në raport me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. Kjo pasi nuk është në qëllimin e Kodit NR. 08/L-032 të Procedurës Penale dhe Kodit Nr.06/L-074 Penal që të kjo fushë të mbetet e pambuluar. Mos mbulimi i kësaj fushe me dispozitë procedurale, do të shndërrohet urdhrin për punë në dobi të përgjithshme në një dënim fakultativ, pa mundësi për revokimin e tij. Kjo do t’ua humbte më pastaj kuptimin edhe dispozitave materiale. Andaj, në rastin konkret, përshtatshmërisht, dispozita e nenit 519 të Kodit NR. 08/L-032 të Procedurës Penale duhet të aplikohet edhe në raport me revokimin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme.

Fillimi i procedurës dhe juridiksioni

Nëse personi i dënuar nuk mban kontakt me shërbimin sprovues, ose nuk e përmbush obligimin e urdhëruar nga gjykata, shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mos mbajtjen e kontaktit, apo mos përmbushjen e obligimit⁵⁹. Njoftimi i bëhet Gjykatës Themelore e cila ka nxjerrë aktgjykimin dënues⁶⁰.

59 Po aty, neni 148.2.

60 Kodi NR. 08/L-032 i Procedurës Penale, përshtatshmërisht, neni 519.1.

Në këtë rast, jo domosdoshmërisht rasti duhet të trajtohet nga gjyqtari/trupi gjykues i njëjtë që ka nxjerrë aktgjykimin dënues. Kështu, në këtë situatë, procedura për revokimin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme konsiderohet rast i ri, i cili i ndahet gjyqtarit, sipas procedurës së rregullt për ndarjen e lëndëve⁶¹. Nisur nga fakti se vendimmarrja i takon kolegjit të gjykatës, gjykata kompetente me rastin e ndarjes së rastit duhet që të caktojë si kolegjin prej tre (3) gjyqtarëve, ku përfshihet kryetari i kolegjit dhe dy (2) anëtarë të kolegjit⁶².

Zhvillimi i procedurës dhe vendimi

Janë dy (2) momente procedurale lidhur me zhvillimin e procedurës për revokimin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, e që janë veprimet që i ndërmerret Kryetari i Kolegjit, para mbajtjes së seancës, dhe veprimet që ndërliidhen nga ana e kolegjit, gjatë dhe pas mbajtjes së seancës.

Me rastin e fillimit të procedurës, para se të mbahet seanca lidhur me revokimin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, Kryetari i Kolegjit merr në pyetje të dënuesin kur është i arritshëm dhe shtron pyetjet e nevojshme për vërtetimin e fakteve dhe mbledhjen e provave që kanë të bëjnë me gjykimin e çështjes, e pastaj shkresat ia dërgon kolegjit. Ndërsa, në rastin kur personi i dënuar nuk është i arritshëm, Kryetari i Kolegjit e analizon dosjen dhe shkresat ia dërgon kolegjit⁶³.

Pas kësaj, Kryetari i kolegjit cakton seancën e kolegjit për të cilën e lajmëron prokurorin e shtetit, të dënuesin dhe të dëmtuarin. Mosprania e palëve dhe e të dëmtuarit ose viktimës nëse janë thirrur me rregull nuk pengon mbajtjen e seancës së kolegjit⁶⁴.

Nëse kolegjii vlerëson se i dënuari nuk ka vepruar në përputhje me obligimet e tij sipas aktgjykimit të Gjykatës, atëherë Gjykata nxjerrë aktgjykim në përputhje me dispozitat materiale që kanë të bëjnë me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme (Shih kapitullin 5 të këtij Manuali).

61 Po aty, përshtatshmërisht, neni 519.2.

62 Po aty, përshtatshmërisht, neni 519.2, lidhur me nenin 19.1.1.21.

63 Po aty, përshtatshmërisht, neni 519.2.

64 Po aty, përshtatshmërisht, neni 519.3.

